Nëse dy ose më shumë oferta kanë të njëjtin çmim më të ulët ose kanë të njëjtat pikë, atëherë fituesi përcaktohet me short, në prani të ofertuesve. Ofertuesit njoftohen për datën dhe kohën e hedhjes së shortit. Mospjesëmarrja

e ofertuesve gjatë procesit të hedhjes së shortit nuk përbën arsye për skualifikim.

D. DHËNIA E KONTRATËS

- 23. Njoftimi i Fituesit**
1. Brenda afatit të vlefshmërisë së Ofertës, Autoriteti/Enti Kontraktor njofton Operatorin Ekonomik të suksesshëm se, Oferta e tij është pranuar, dhe është shpallur fituese.
- 24. Nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër/ Kontratës**
1. Pas konfirmimit të fituesit/ve Autoriteti/Enti Kontraktor përgatit, nënshkruan dhe fton Operatorin/ët e suksesshëm Ekonomik të nënshkruajë Marrëveshjen kuadër/Kontratën.
 2. Autoriteti/Enti Kontraktor i kërkon fituesit një sigurim për realizimin e Kontratës. Shuma e mbulimit për realizimin e kontratës do të jetë 10% e vlerës së Kontratës. Formulari i Sigurimit të Kontratës, dorëzohet para nënshkrimit të Kontratës.
- Sigurimi për realizimin e kontratës mund të paraqitet në një nga format e mëposhtme:
- a) garanci bankare
 - b) garanci nga shoqëri sigurimi.

DH. ANKESAT

- 25. Procedura e ankesës**
1. Çdo Operator Ekonomik, i cili ka interes për objektin e prokurimit dhe rrezikon të dëmtohet nga vendimmarrja e autoritetit/entit kontraktor mund të paraqesë ankesë njëkohësisht pranë autoritetit/entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik në lidhje me Dokumentet e Tenderit, kualifikimin, përzgjedhjen ose përcaktimin e ofertës fituese, sipas parashikimeve në LPP dhe aktet nënligjore.
 2. Autoriteti/Enti Kontraktor mund t'i kërkojë Komisionit të Prokurimit Publik që të lëshojë masa të ndërmjetme për mospezullimin e procedurës së prokurimit.

E. ANULIMI I PROCEDURËS

- 26. Anulimi i procedurës**
1. Autoriteti / Enti kontraktor publikon Njoftimin për Anulimin e Procedurës së Prokurimit, në të njëjtën mënyrë siç publikon Njoftimin e Kontratës, jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e skadimit të afatit të fundit për paraqitjen e ankesave, ose dhënien e vendimit përfundimtar për ankimin.
 2. Autoriteti/ enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur:
 - a) nuk është paraqitur asnjë kërkesë përkatëse në procedurat me faza;

- b) nuk është paraqitur asnjë ofertë e përshtatshme në procedurat me një fazë;
- c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;
- d) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit ose entit kontraktor ka ndryshuar;
- e) Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin në përputhje me parashikimet në LPP;

Gjithashtu, Titullari i autoritetit/entit vendos anulimin e procedurës sipas përcaktimeve në nenin 19 të LPP dhe nenin 75 të VKM 285/2021.

3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti/ enti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.

SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 1. Formulari i Ofertës

Shtojca 2. Listat e Çmimeve të Shërbimeve

Shtojca 3. Formulari i Sigurimit të Ofertës

Shtojca 4. Lista e Informacionit Konfidencial

Shtojca 5. Formulari i Specifikimeve Teknike

Shtojca 6. Formulari i Shërbimeve dhe Grafikut të ekzekutimit

Shtojca 7. Formulari i Termave të Referencës

Shtojca 8. Formulari i Kritereve të Përzgjedhjes së Ofertuesve

Shtojca 9. Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit

Shtojca 10: Formulari i Njoftimit të skualifikimit

Shtojca 11: Formulari i Njoftimit të Fituesit

Formulari 12- Formulari i Njoftimit të Fituesit (Pas procesit të ankimit)

Shtojca 13: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër

Shtojca 14: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër (Pas procesit të ankimit)

Shtojca 1.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI I OFERTËS

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

- (a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:*[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]*, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
- (b) Ne *[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]*, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës *[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]*.
- (c) Ne ofrojmë të kryejmë për Autoritetin/Entin Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Shërbimet për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
- (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme::
 - 1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
 - 2. Njoftimin e Kontratës;
 - 3. Kriteret e Përzgjedhjes;
 - 4. Specifikimet teknike, grafikun e ekzekutimit dhe termat e referencës;
 - 5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
 - 6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
 - 8. Listat e Çmimeve të Shërbimeve.
- (e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**
- (f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

| | |
|---|--|
| Emri i përfaqësuesit të ofertuesit | |
| Nënshkrimi | |
| Vula | |
| Datë _____ | |

Shtojca 2.*(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)***LISTA E ÇMIMEVE TË SHËRBIMEVE****Data:** _____**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:**
_____**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE):** _____**Monedha:** _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të rregullohen në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë artikujt në Formularin e Shërbimeve dhe grafikut të ekzekutimit duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimeve për shërbimet. Shërbimet pa çmim do të konsiderohen si shërbime të paofruar dhe do të cojnë në refuzimin e ofertës.

Lista e Çmimeve

| <i>1</i> | <i>2</i> | <i>3</i> | <i>4</i> | <i>6</i> | |
|---|--|--------------|-------------------------------|--------------------------------|--|
| Artikulli | Përshkrimi i shërbimit | Sasia | Numeri rojeve/vendroje | çmimi për njësi | Çmimi total për shërbim 48 muaj |
| 1. | Shërbim Ruajtje 24 orësh (Turn I+II+III) Bashkia Bulqize | 1 | 4.98 | | |
| 2. | Shërbim Ruajtje 24 orësh (Turn I+II+III) Antena | 1 | 4.98 | | |
| 2. | Shërbim Ruajtje 16 orësh (Turn II+III) ruajtje me kamera | 1 | 3.32 | | |
| 4. | Shërbim Ruajtje 8 orësh (Turn III) shkolla tre | 3 | 1.66 | | |
| | | | | Çmimi total (shërbimit) | _____ |
| Çmimi Neto pa TVSH | | | | | |
| TVSH (%) | | | | | |
| Çmimi total me TVSH: | | | | | |
| Emri i përfaqësuesit të ofertuesit | | | | | |
| Nënshkrimi | | | | | |
| Vula | | | | | |
| Datë _____ | | | | | |

| Preventivi per sherbimi 24 oresh + sherbim | | |
|---|---|------------------------------|
| <i>Nr</i> | <i>Pershkrimi</i> | <i>Vlera ne leke pa TVSH</i> |
| 1 | Paga baze e punojesis sipas ligjit Nr. 75/2014 "Per sherbimin privat te sigurise fizike". | |
| 2 | Shtesa per turnin e dyte | |
| 3 | Shtesa per turnin e trete | |
| 4 | Sigurimet shoqerore dhe shendetesore | |
| 5 | Shuma (1+2+3+4) | |
| 6 | Fitimi i parashikuar | |
| 7 | | |
| Kostoja totale mujore (5+6+7) per 1 Punonjes | | |
| Kostoja totale mujore per 1 vendroje | | |

| Preventivi per sherbimi 16-oresh + sherbim | | |
|---|---|------------------------------|
| <i>Nr</i> | <i>Pershkrimi</i> | <i>Vlera ne leke pa TVSH</i> |
| 1 | Paga baze e punojesis sipas ligjit Nr. 75/2014 "Per sherbimin privat te sigurise fizike", | |
| 2 | Shtesa per turnin e dyte | |
| 3 | Shtesa per turnin e trete | |
| 4 | Sigurimet shoqerore dhe shendetesore | |
| 5 | Shuma (1+2+3) | |
| 6 | Fitimi i parashikuar | |
| Kostoja totale mujore (4+5+6) per 1 Punonjes | | |
| Kostoja totale mujore per 1 vendroje | | |

| Preventivi per sherbimi 8-oresh + sherbim | | |
|---|---|------------------------------|
| <i>Nr</i> | <i>Pershkrimi</i> | <i>Vlera ne leke pa TVSH</i> |
| 1 | Paga baze e punojesis sipas ligjit Nr. 75/2014 "Per sherbimin privat te sigurise fizike", | |
| 2 | Shtesa per turnin e trete | |
| 3 | Sigurimet shoqerore dhe shendetesore | |
| 4 | Shuma (1+2) | |
| 5 | Fitimi i parashikuar | |
| Kostoja totale mujore (3+4+5) per 1 Punonjes | | |
| Kostoja totale mujore per 1 vendroje | | |

.Analiza e kostos

Operatorët janë të detyruar të paraqesin preventivin sipas zerave të mesiperm, duke pasqyruar të gjitha kostot për të cilat kanë detyrime ligjore në zbatim të VKM, "Për percaktimin e pagës minimale në shkallë vendi", Ligji Nr.7961, datë 12.7.1996, "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, Ligji 75/2014 "Për Shërbimin Privat të Sigurisë Fizike" dhe aktet nenligjore në zbatim të tij, legjisllacionin për sigurimet shoqerore dhe shendetesore në fuqi si dhe çdo detyrim tjetër ligjor në fuqi.

**.Numri i punonjësve te nevojshem të shërbimit për një vëndroje me tre turne te llogaritet•
4.98 (Ore pune/punonjes/muaj: 174 ore). Koeficienti i zevendesimit 1.66 për çdo punonjës
shërbimi).**

**.Çdo ofertë e paraqitur nga operatorët ekonomik ku zërat e kostos në plotësimin e
preventivit• (si psh: paga bazë, shtesat mbi pagë, sigurimet shoqërore e shendetesore),
rezultojnë të jenë nën kufirin minimal ligjor të lejuar, do të skualifikohen.**

.Çmimet duhet të shprehen në Monedhën Lek (e kërkuar ne dokumentat e tenderit).

. Klasifikimi i ofertave behet mbi bazen e vleres se ofertes se dhene ne total.

Shtojca 3.

[Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

* * *

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit/entit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës se prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 4.

(Shtojcë për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

| Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial | Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale | Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni | Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni |
|---|---|--|--|
| | | | |
| | | | |
| | | | |
| | | | |
| | | | |

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 5.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Specifikimet Teknike të shërbimeve objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Sherbimi do te kryhet per 8 ore me 1.66 roje.

16 ore me 3.32 roje .

24 ore me 4.98 roje .

Shërbimi i ruajtjes fizike :

- Roja duhet te jene te pajisur e mjete mbrojtese, me uniforma dhe dokument identifikimi dhe mjete te tjera llogjistike, sic parashikohet nga ligji 75/2014 "Për shërbimin privat të sigurisë fizike" .

- Te ruaje objektin qe i eshte besuar, te ruaje rendin ne to si dhe te siguroje jeten e personelit.

- Per ruajtjen e objekteve te rendesise se vecante, **ofertuesi duhet te pajise punonjesit e sherbimit me arme krahu dhe per objektet e tjera me arme brezi**, sipas percaktimeve ligjore te ligjit.75/2014"Për shërbimin privat të sigurisë fizike"

- Sherbimi i ruajtjes fizike 24 ore do te flloje ne oren 08:00 ne mengjes dhe do te mbaroje ne oren 8:00 te dites se neserme.

Per sherbimin 8 oresh do te filloje ne ore 23:00 ne darke dhe mbaron ne oren 8:00 ne mengjes te dites se neserme.

Per shërbimi 16 oresh. do te filloje ne oren 16:00 pasdite , do te mbaroje ne oren 8:00 ne mengjes te dites se neserme.

Sherbimi do te ofrohet nga e Hena ne te Diele.

Ofruesi i Shërbimit duhet të plotësojë kërkesat e mëposhtme :

a) **Te jetë i licensuar nga autoritetet kompetente për ushtrimin e funksionit si roje i ruajtjes dhe sigurisë fizike (kopje e licenses/certifikates).**

b) **Të reflektojë një sjellje korrekte dhe të respektueshme.**

c) **Pajisja me mjet identifikimit si roje e ruajtjes dhe sigurisë fizike gjatë gjithë kohës së shërbimit duhet të mbahet në vend të dukshëm.**

d) **Gjatë gjithë kohës së shërbimit punonjësi i kompanisë SHPSF duhet të respektojë rregullat e brendshme të Bashkise Bulqize.**

e) **Punonjësi i ofruesit të shërbimit duhet të jetë i aftë të reagojë dhe veprojë gjithmonë në përputhje me instruksionet e personave përgjegjës të përcaktuar nga Bashkia Bulqize.**

f) **Të gjithë punonjësit e ofruesit të shërbimit të kërkuar duhet të jenë të pajisur me uniformen dhe të gjitha materialet e nevojshme llogjistike sipas ligjit Nr. 75/2014 “Për shërbimin privat të sigurisë fizike” te publikuar ne fletoren zyrtare date 08.08.2014, si dhe në aktet nënligjore.**

g) **Të ushtrojnë kontrole të herë pas hershme në objektin ku kryen sherbimin, për të parandaluar veprimet e kundërligjshme.**

h) **Për persona të jashtëm që vijnë për probleme pune, duhet të njoftojnë më parë punonjësin që kërkohet dhe me lejën e tij i shoqërojnë tek ai.**

i) **Të kërkojnë nga shtetasit dhe punonjësit të zbatojnë rregullat e brendshme të objektit.**

Shtojca 6

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT

Shërbimi që kërkohet: “Shërbim sigurie i ruajtjes fizike të ndërtesave, aseteve, dhe njerëzve të Bashkisë Bulqize”

Afatet e ekzekutimit: 48 muaj

Vendndodhja e shërbimit:

| Numri i Vendrojeve | Numri i turneve | Numri i rojeve te nevojshme | Afati i levrimit |
|--------------------|------------------|-----------------------------|---|
| 3 | (8 ore shërbim) | 1.66 | 48 muaj <i>Kontratat do të jepen nga momenti i lidhjes së Marrëveshjes Kuadër me OE shpallur fitues nga kjo procedure prokurimi, sipas përcaktimit të AK me afat perfundimtar 48 muaj.</i> |
| 1 | (16 ore shërbim) | 3.32 | 48 muaj <i>Kontratat do të jepen nga momenti i lidhjes së Marrëveshjes Kuadër me OE shpallur fitues nga kjo procedure prokurimi, sipas përcaktimit të AK me afat perfundimtar 48 muaj.</i> |
| 2 | (24 ore shërbim) | 4.98 | 48muaj <i>Kontratat do të jepen nga momenti i lidhjes së Marrëveshjes Kuadër me OE shpallur fitues nga kjo procedure prokurimi, sipas përcaktimit të AK me afat perfundimtar 48 muaj.</i> |

1. Shërbimi 8 orar në vendrojet me 1.66 roje, do të kryhet me punonjes shërbimi nga ora 23:00 deri 08.00 shërbimi do të kryhet me punonjes shërbimi nga dita e Hënë deri ditën e Diel.
2. Shërbimi 16 orësh në vendroje me 3.32 roje, do të kryhet me punonjes shërbimi në turnin e dytë dhe i tretë nga ora 16:00 dhe turni i dytë 16:00 deri 08.00 . Shërbimi me punonjes shërbimi do të kryhet nga dita e Hënë deri ditën e Diel.
3. Orari 24 orësh në vendroje me 4.98 roje do të kryhet me punonjes shërbimi nga ora 08:00 deri 08:00 është nga e Hëna në të Diele, përfshirë dhe ditët e festave. Kjo vlen për të gjitha shërbimet dhe ato 24 orësh.

Shtojca 7

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

FORMULARI I TERMAVE TË REFERENCËS

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve: “Shërbim sigurie i ruajtjes fizike të ndërtesave, aseteve, dhe njerëzve të Bashkisë Bulqize”.

Kontratat do të lidhen sipas afateve të përcaktuara nga AK.

2. Objektivat:

- Të ruajë objektin në zbatim të Rregullores së Brendshme të institucionit.
- Të ruajë rendin dhe të sigurojë jetën e personelit.

Detyrat: Detyrat e kontraktorit:

Kontraktori ka për detyrë:

- Të hartojë Rregulloren e Shërbimit dhe t’ja paraqesë Autoritetit Kontraktor.
- Të hartojë grafikun e shërbimit duke siguruar shërbimin e vazhdueshëm në të gjitha ditët e javës me turne dhe t’ja paraqesë çdo muaj Autoritetit Kontraktor, duke përcaktuar emrat e punonjësve të shërbimit për çdo ditë dhe për çdo turn.
- Të ndërhyjë me grupin e gatshëm, në bazë të legjislacionit në fuqi, në çdo rast që paraqitet nevoja dhe të bashkëpunojë me policinë e rendit në interes të forcimit dhe të rritjes së efektshmërisë së veprimit në rast të cenimit të institucionit ose të personelit.

Punonjësi i shërbimit ka për detyrë:

- Të zbatojë Rregulloren e Shërbimit të hartuar nga Drejtuesi Teknik
- Të zbatojë Rregulloren e Brendshme të institucionit
- Të zbatojë grafikun për shërbimin me rojet private duke u paraqitur 10 minuta përpara dorëzimit të turnit.
- Të sigurojë ruajtjen dhe rendin në këtë objekt.
- Të mos lejojë futjen e personave në objekt pa flete-hyrje.
- Të mos lejojë hyrjen dhe daljen e materialeve pa dokumentin përkatës.
- Të sigurojë parkimin e automjeteve të A.K sipas vendeve të përcaktuara nga institucioni.
- Të kontrollojë masat e sigurisë së objekteve si rrethimin, ndriçimin, gadishmërinë e sistemit të ndërlidhjes, mbrojtjes ndaj zjarrit dhe për çdo parregullsi të informojë duke vënë në dijeni përgjegjës të tij dhe ky i fundit njofton personin e autorizuar të Autoritetit Kontraktor për çdo mangësi të konstatuar.

- Para marrjes së shërbimit, kontrollon objektin në prezencë të rojes dorëzuese dhe për çregullimet e konstatuara njofton përgjegjësën e rojeve dhe përgjegjësën e shërbimeve të brendshme të institucionit, duke bërë shënimet përkatëse në librin e shërbimit.
- Të njohë dhe zbatojë rregulloren për mbrojtjen kundra zjarrit. Në rast zjarri të marrë masa për shuarjen e tij dhe menjëherë njofton zjarrëfikset, përgjegjësën e rojeve dhe përgjegjësën e shërbimeve të brendshme të institucionit.
- Kur në objekt kryhen vepra penale, roja bën bllokimin e mjedisit dhe të autorit dhe njofton menjëherë organet kompetente
- Të jetë i paisur me armë dhe ta përdorë atë në bazë të legjislacionit në fuqi.
- Të karakterizohet nga sjellja qytetare në komunikim me personat.
- Ndalohet futja dhe qëndrimi i rojës në ambjentet e brendëshme të objektit përjashtuar rastet për zbatimin e rregullores.
- Rojes, gjatë kohës së shërbimit i ndalohet të pijë pije alkolike, të flejë, të bisedojë me persona të jashtëm.
- Të bashkëpunojë me policinë e rendit në interes të forcimit dhe të rritjes së efektshmërisë së veprimit në rast të cënimit të institucionit ose të personelit.

Shpërndarja:

Shpërndarja: Shpërndarja do të jetë sipas tabelës me vendrojet që janë në këtë prokurim në vendet përkatëse.

Afati i kryerjes të shërbimit: 48 muaj nga nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër me të drejtë ndërprerje të menjëhershme në rast se Illyrian Guard sh.a merr përsipër kryerjen e shërbimit.

Vendi i kryerjes së shërbimeve:

| Emertimi i objektit | Nr. vendrojeve | Institucioni | Oret e shërbimit | Koeficienti |
|----------------------------|-----------------------|------------------------|-------------------------|--------------------|
| <i>Bashkia Bulqize</i> | <i>1</i> | <i>Bashkia Bulqize</i> | <i>24 ore</i> | <i>4.98</i> |
| <i>Antena</i> | <i>1</i> | <i>Bashkia Bulqize</i> | <i>24 ore</i> | <i>4.98</i> |
| <i>Shkollat</i> | <i>3</i> | <i>Bashkia Bulqize</i> | <i>8 ore</i> | <i>1.66</i> |
| <i>Kontroll me kamera</i> | <i>1</i> | <i>Bashkia Bulqize</i> | <i>16 ore</i> | <i>3.32</i> |

Kontrolli me kamera, ku bejne pjese keto objekte ne varesi te Bashkise Bulqize:

- Kopeshti "Eleni Kolla"
- Kopeshti i Qytetit te Ri
- Çerdhe ne qytetin e vjeter
- Çerdhe ne qytetin e ri
- Shkolla e mesme "Fushe Bulqize"
- Shkolla 9 vjeçare "Demokracia"
- Shkolla 9 vjecare Shupenze
- Shkolla e mesme Shupenze
- Shkolla 9 vjeçare Gjorice
- Shkolla e mesme Ostren
- Shkolla e mesme Martanesh
- Shkolla 9 vjeçare Godvi

Shtojca 8

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv)
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;
- dh) nuk ka pagesa të pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 9.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/EntiKontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

- Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.

- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

Shënim: Në zbatim të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021”Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar me VKM-në nr.710, datë 24.11.2021 neni 26/6 **me kërkesë të Autoritetit Kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit**, operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet të dorëzojë fizikisht pranë BASHKISE BULQIZE dokumentacion provues të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të neni 26/2 të VKM-së të sipërcituar , si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike .

Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin.

Autoriteti/enti kontraktor merr një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose një palë e tretë që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike.

Në rast se operatorët ekonomikë të parë të kualifikuar janë një bashkim operatorësh ekonomik, secili prej operatorëve ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mësipërm, marrëveshjen e bashkëpunimit sipas së cilës është krijuar bashkimi i operatorëve ekonomikë dhe deklaratën për emërimin e një përfaqësuesi të sindikatës. të operatorëve ekonomikë. operatorët.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3; perkatesisht në vleren 1 301 209 (njemilion e treqind e njemije e dyqind e nente) leke pa tvsh, dhe në monedhën euro sipas kursit të datës 10.10.2022 është 11 169 (njembedhjetemije e njeqind e gjashtedhjetë e nente) Euro. (kursi i dites, per konvertimin e lekut ne euro eshte 116,5)*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a) Operatori ekonomik duhet të paraqesë në sistemin e prokurimeve elektronike, Liçencën e shoqerise për ushtrimin e aktivitetit në fushën e “Shërbimi privat te sigurise fizike”, lëshuar ne baze te Ligjit nr. 75/2014, nenkategoria 1.3.A.
- b) Operatori ekonomik duhet të paraqesë në sistemin e prokurimeve elektronike Licencë të drejtuesit teknik për ushtrimin e aktivitetit të ruajtjes dhe sigurimit fizik të objekteve publike dhe private, në kategorinë ”1.3.A” me kohe te plote, lëshuar nga organi kompetent, konform Ligjit Nr.75/2014 “Për shërbimin privat të sigurisë fizike” dhe Udhezimit te Ministrit te Brendshem nr.130, date 05.03.2018, nenkategoria I.3.A.
- c) Operatori ekonomik duhet të paraqesë në sistemin e prokurimeve elektronike Licencë të Administratorit për ushtrimin e aktivitetit të ruajtjes dhe sigurimit fizik të objekteve publike dhe private, në kategorinë ”1.3.A” me kohe te plote, lëshuar nga organi kompetent, konform Ligjit Nr.75/2014 “Për shërbimin privat të sigurisë fizike” dhe dhe Udhezimit te Ministrit te Brendshem nr.130, date 05.03.2018, nenkategoria I.3.A.
- d) Operatori ekonomik duhet te paraqese në sistemin e prokurimeve elektronike certifikatat e punonjesve te sherbimit, për jo më pak se **18** punonjës për nënkategorinë 1.3.A, konform Ligjit Nr. 75/2014 “Për shërbimin privat të sigurisë fizike”, shoqeruar me listen emerore te punonjesve te sherbimit te deklaruar ne DVP, Diber, te nenshkruar nga drejtuesi teknik dhe administratori.

Punonjesit e pasqyruar ne listen emerore te nenshkruar nga drejtuesi teknik dhe administratori, duhet te figurojne ne listepagesat e sigurimeve shoqerore minimumi 3 muajt fundit. Ne rast bashkimi te operatoreve ekonomik , kjo liste duhet te paraqitet ne perputhje me perqindjen e marr persiper në kontratën e bashkëpunimit.

Shënim: Përsa i përket listëpagesave të sigurimeve shoqerore minimumi 3 muajt fundit operatori ekonomik duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës nr.9.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime

Shënim: Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari për pikën e listëpagesave duhet te dorezojë pranë AK, **përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit**, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Sipas kushteve të përgjithshme të kualifikimit.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2019, 2020, 2021 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% të fondit limit.

2.2.2 Operatori Ekonomik duhet të ketë një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm gjatë 3 (tre) viteve të fundit 2019, 2020, 2021. Për të vërtetuar plotësimin e këtij kushti Operatori Ekonomik duhet të paraqesë kopje të bilanceve të 3(tre) viteve të fundit, të konfirmuara nga autoritetet përkatëse. Kriteri quhet i përmbushur nëse në bilancet e 2 viteve të njëpasnjëshme nuk kanë raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Në çdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose të kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Shënim: Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet të dorëzojë pranë AK, **përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit**, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Shërbime të ngjashme me objektin e prokurimit me vlerë jo më të vogël se **40% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet përkatësisht 26 024 178,8 (njetzet e gjashtë milion e njetzekatëmbëdhjetë e shtatëdhjetë presje tete) lekë pa tvsh të kryera gjatë tri viteve të fundit** (përlogaritur nga data e shpalljes të njoftimit të kontratës).

Për të vërtetuar përmbushjen e kriterit të sipërpërmendur Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, dhe faturat tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Ose

b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

2.3.2 Operatori Ekonomik të ketë Qender Kontrolli në Qarkun Diber.

Për të dëshmuar përmbushjen e kriterit të sipërcituar, operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të paraqesin në sistemin elektronik Akt Miratim të lëshuar nga Drejtoria Vendore e Policisë të Qarkut Diber.

2.3.3 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë në sistemin e prokurimeve elektronike, **Vërtetim lëshuar nga Drejtoria Vendore e Policisë Qarkut Diber**, lëshuar jo më parë se nga data 01.04.2022 e në vazhdim, ku të jepet informacioni si mëposhte:

I. Kontratat e shërbimit, me roje dhe kamera, që ka operatori në ruajtje.

II. Numrin e punonjësve të shërbimit gjithsej, jo më pak se **18** punonjës, **te certifikuar** në bazë të ligjit nr.75/2014.

III. Te këto 1 (nje) Përgjegjës Shërbimi.

IV. Te këto jo më pak se 5 (pese) operatore për Qendren e Kontrollit,

V. Te këto Grup të gatshëm punonjesisht, të përbërë nga minimumi 3 (tre) punonjës.

VI. Te këto performanca të mira në ushtrimin e aktivitetit.

VII. Vërtetimi i DVP Diber të jete i shoqëruar me listën e emerore të 18 punonjësve të deklaruar

2.3.4 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë në sistemin e prokurimeve elektronike, **Autorizim individual, lëshuar nga Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare, për "Radiokomunikimin"** konform Ligjit Nr.9918 datë 19.05.2008, "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë", sipas të cilit operatori ekonomik të jete liçencuar për përdorim të frekuencave për radiokomunikim dhe radioalarm në zonat ku ndodhen objektet ku do të kryhet shërbimi.

2.3.5 Vërtetim nga Drejtoria e Tatimeve për numrin e punonjësve të siguruar për 3 (tre) muajt e fundit nga data e hapjes së ofertave, shoqëruar me listë pagesat e sigurimeve shoqërore (formularët E-sig 025 a) për këtë periudhë të konfirmuara nga organet tatimore.

Operatori ekonomik duhet të ketë minimalisht **18** punonjës të siguruar në muaj, **përveç** drejtuesin teknik dhe administratorin.

Shënim: Për pikën 2.3.5 më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës nr.9.

Shënim: Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

2.3.6 Operatori ofertues të disponojë automjete, në emër të shoqërisë, në pronësi apo të marra me qira, për ndërhyrjet në raste emergjente, jo më pak se 1 (nje) automjet për përballimin e situatave emergjente.

I. Pronesia e automjeteve të vërtetohet duke paraqitur lejen e qarkullimit të tyre, siguracion të vlefshëm, akt-kolaudimi të vlefshëm dhe taksa të paguara.

II. Marrja me qera ose huapërdorja e automjeteve të mesiperme, do të pranohet vetëm nëse kontrata/t e qiramarrjes ose të huapërdorjes janë të lidhura para noterit, dhe të shoqëruara me lejen e qarkullimit, siguracion të vlefshëm, akt-kolaudimi të vlefshëm dhe taksa të paguara.

Shënim: Për pikën 2.3.6 më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës nr.9.

Shënim: Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

2.3.7 Operatori Ekonomik duhet të vërtetojë se disponon në pronësi jo më pak 5 (pese) arme brezi të Kategorisë 1.3 A. Për të vërtetuar këto duhet të paraqesë:

1. Autorizim për blerje arme zjarri Kategorija 1.3 A lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë.
2. Kontrata shitblerje arme me një shoqëri të licensuar për shitblerje armesh shoqëruar me numrin serial për secilën armë.
3. Faturat tatimore shoqëruar me mandat pagesat e bankës.

Për sa më sipër, Autoriteti Kontraktor gjykon se në dokumentat e tenderit është përcaktuar qartesisht se kategoria e shërbimit përfshin disponimin e kategorisë së Licensës / Licensave 1.3.A për Shërbimin Privat të Sigurisë Fizike, kështu që edhe armët e kërkuara në këtë objekt prokurimi do të përdoren për Shërbimin Privat të Sigurisë Fizike me Roje Private të subjekteve të Licensuara me Kategorinë 1.3.A.

Shënim: Për pikën 2.3.6 më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës nr.9.

Shënim: Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

2.3.8 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin analizen e kostos për ofertën e paraqitur (preventiv për një roje dhe një vendroje në muaj). Operatorët ekonomikë duhet të përcaktojnë çmimin e ofertës duke respektuar aktet ligjore dhe nenligjore në fuqi (si p.sh.: pagesa bazë, shtesat mbi pagesa, sigurimet shoqërore...etj). Ofertat që nuk respektojnë kërkesat ligjore do të konsiderohen nenkoston ligjore dhe do të skualifikohen.

Në rastin e Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë, kandidatët/ofertuesit duhet t'i përmbahen VKM-së nr.285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, si dhe të respektojnë rigorozisht udhëzimet e APP për operatorët ekonomikë për rastin e bashkimit të operatoreve në procedurat elektronike të prokurimit.

Në të gjitha rastet kur përmendet çertifikatë, markë, emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjine specifike, prodhues ose sipërmarrës pranohet edhe ekuivalent i tyre.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Shtojca 9.

(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

I. Unë i nënshkruari _____ në cilësinë e _____ të operatorit ekonomik _____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik

| Identifikimi | Përgjigja |
|---|-----------|
| Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE | ----- |
| Numri NIPT/et: | ----- |
| Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar | ----- |
| Përfaqësuesi (emri): | ----- |
| Telefoni: | ----- |
| E-mail: | ----- |

B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)

